

21 DHJETOR 2023

# RAPORT I ZMADHIMIT TE KAPITALIT

ME KONTRIBUT NGA FONDE TE AKSIONERIT

PERGATITUR NGA: ARBER GJATA - AUDITUES LIGJOR  
LICENSA NR. 245 DT. 27.08.2012

SHOQERIA TREGETARE: FUTBOLL CLUB DINAMO CITY SH.A. - M12121037S

SELIA: Rruga "Asti Gogoli" Lagjia nr.14, Pasuria me  
nr.5/104, Vòl.9, faqe 214, ZK.8516, Durrës

**RAPORT I**  
**AUDITUESIT LIGJOR (EKSPERTIT KONTABEL TE RREGJISTRUAR)**

**MBI SHTIMIN E KAPITALIT TE NENSHKRUAR TE SHOQERISE**

**" FUTBOLL CLUB DINAMO CITY " SH.A.**

Unë i quajtori **Arber GJATA** Auditues Ligjor (Ekspert Kontabel i Rregjistruar) i ngarkuar nga Aksioneri i Vetëm i Shoqërisë "**FUTBOLL CLUB DINAMO CITY " Sh.A. me Vendimin Nr. 4 të datës 23.11.2023** për verifikimin dhe vërtetimin e shtesës së kapitalit nga rritja e aktivitet të kryera e të mbuluara nga fonde të vetë aksionerit të vetëm, paraqes raportin si më poshtë:

**Drejtuar:** AKSIONERIT TË VETËM TË SHOQËRISË "**FUTBOLL CLUB DINAMO CITY**" Sh.A., Z. Adrian Bardhi

**Qëllimi i Angazhimit:**

Asambleja e përgjithshme e aksionerëve të shoqërisë me vendimin Nr.4 date 23.11.2023 më ka angazhuar si Auditues Ligjor (Ekspert Kontabel i Rregjistruar) për të verifikuar dhe për të dhënë siguri të arsyeshme mbi përgatitjen dhe paraqitjen me vërtetësi të shumave të zmadhimit të kapitalit nga derdhja e kontributeve në para të aksionerit, sipas derdhjeve të paraqitura në levizjet bankare të shoqërisë për periudhën që mbyllet me 31 Dhjetor 2022 dhe përgjatë vitit 2023.

**Kriteret**

Si bazë për angazhimin e verifikimit të zmadhimit të kapitalit ne kemi përdorur sa më poshtë referuar:

- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit,
- Ligji Nr.25/2018 " PËR KONTABILITETIN DHE PASQYRAT FINANCIARE",
- Ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"
- Pasqyrat financiare të Shoqërisë "**FUTBOLL CLUB DINAMO CITY " sh.a,** të periudhës kontabel të mbylluar më 31 dhjetor 2022 (janë të audituara).
- Pasqyrat financiare të Shoqërisë "**FUTBOLL CLUB DINAMO CITY " Sh.a** provizore për zërat e prekur nga rritja e kapitalit, të periudhës kontabel të mbyllur më 30 Nëntor 2023 janë të pa audituara.
- Ligji Nr. 8438 datë 28.12.1998 Per tatimin mbi të ardhurat i ndryshuar
- Udhezim Nr. 5 datë 30.01.2006 Për tatimin mbi të ardhurat i ndryshuar
- Statuti i Shoqërisë „**FUTBOLL CLUB DINAMO CITY**" Sh.A.
- Deklarata individuale vjetore e të ardhurave të Z. Adrian BARDHI për vitin 2019.
- Vërtetim/Konfirmim i tërhequr nga Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës për „**INDIVIDIN KONTRIBUES NË SHTIMIN E KAPITALIT NË FORMËN MONETARE NGA JASHTË SHOQËRISË**" me Nr. 7509/1 Prot. Dt. 21/12/2023

**Përgjegjësia e Drejtimit**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare në përputhje me kriteret e sipërpërmendura. Kjo përgjegjësi përfshin: përcaktimin, ushtrimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare të cilat nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve; zgjedhjen dhe zbatimin e parimeve të duhura kontabile; dhe kryerjen e çmuarjeve kontabile të arsyeshme për rrethanat financiare.

**Përgjegjësia e Audituesit Ligjor**

Përgjegjësia jonë është që, bazuar në procedurat e kryera, të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare. Ne e kryem auditimin në pajtim me Standartet Nderkombetare të Angazhimeve të Dhënies së Sigurisë (SNAS 3000) "Angazhime të dhënies së Sigurisë që ndryshojnë nga Auditimet apo rishikimet e Informacioneve Financiare Historike" dhe standardet e tjera që lidhen me çështjen në fjalë. Këto standarde kërkojnë që ne të planifikojmë dhe të kryejmë procedurat e nevojshme për të siguruar një nivel sigurie të arsyeshme që informacionet e përgatitura nga drejtimi i shoqërisë për kapitalet e veta janë të vërteta dhe të sinqerta, në të gjitha aspektet materiale.





#### **Procedurat e kryera nga ana e Audituesit Ligjor për këtë angazhim perfshijne:**

1. Verifikim i përputhshmërisë së shifrave të ndodhura në zërat e kapitalit të vet të shoqërisë dhe krijimit të këtyre posteve.
2. Verifikim i shifrave të derdhura si kontribut në para nga Aksioneri i Vetëm në Pasqyrat financiare të vitit ushtrimor të mbyllur më 31 Dhjetor 2022 dhe me 30 Nëntor 2023.
3. Verifikimin e burimit të të ardhurave dhe vërtetimin që këto të ardhura janë të tatuara (bashkëngjitur dokumentat sipas kërkesave ligjore).
4. Verifikimin e llogaritjeve për numrin e aksioneve si efekt të zmadhimit të kapitalit aksionar.
5. Verifikimin e ndryshimeve në dokumentacionin Ligjor të Krijimit të Shoqërisë si Statutin, Aktin e Themelimit të Shoqërisë " FUTBOLL CLUB DINAMO CITY " SH.A..
6. Rishikim dhe verifikim i gjithë dokumentacionit si kontrata, vendime, akte ligjore ndihmëse për të vërtetuar vlerën e zmadhimit të kapitalit.

#### **Zhvillimi i raportit të Audituesit Ligjor:**

Shoqëria " FUTBOLL CLUB DINAMO CITY " SH.A. " është rregjistruar si person juridik në datë 21/09/2021 dhe ka për objekt të veprimtarisë së saj:

*Krijimi, zotrimi, menaxhimi, mbajtja e të drejtave të ekipeve sportive dhe /ose të klubeve sportive, organizimi i evenimenteve sportive dhe kulturore, krijimi dhe pjesëmarrja në turne sportive brenda dhe jashtë vendit, pjesëmarrja dhe antaresimi në federata kombëtare dhe nderkombëtare, pjesëmarrja në evenimente sportive dhe kampionate sportive të organizuara nga federata kombëtare dhe nderkombëtare të futbollit, institucione publike/shtetërore shqiptare, të huaja apo nderkombëtare. Krijimi, zotërimi, menaxhimi i shkollave sportive, profesionale, akademike sportive, kurseve sportive me qëllim trajnimi apo ushtrimi të aktivitetit sipas pikës 5.1.1 me lart. Krijimi dhe regjistrimi i markave tregtare, zotërimi i të drejtave të markave tregtare, zotërimi i licencave dhe të drejtave përdorimit të markave tregtare. Menaxhimi i të drejtave të autorit, markave, imazhit, figurës, ipjesëmarrjes në evenimente sportive, kulturore, kampionate si dhe të çdo evenimenti të çfarëdo natyre për sportistë, trajnerë, si dhe përdorimi dhe/ose shitja apo dhënia në përdorim të përkohshëm të tyre. Organizimi i evenimenteve sportive dhe kulturore. Zotërimi, menaxhimi dhe mbajtja e të drejtave të federimit (kartonit) në federata sportive, të lojtarëve, trajnerëve, sportistëve, teknikëve sportiv, transferimi i tyre, shitja apo dhënia në përdorim të përkohshëm. Rekrutimi i lojtarëve, sportistëve, trajnerëve, teknikëve sportiv. Shërbime të prokurorit/ndërmjetësit/menaxherit sportiv. Shitje, blerje, prodhim, tregti me shumicë dhe pakicë të artikujve sportivë, veshjeve, aksesoreve, si dhe të çdo artikulli industrial. Aktivitete reklamimi. Zotërimi i pasurive të paluajtshme, apo përdorim dhe menaxhim i tyre. Zotërimi, menaxhimi, administrimi dhe/ose ushtrimi i aktivitetit të qendrave shëndetësore, qendrave të fizioterapisë, të masazherisë, të asistencës shëndetësore, spitale, si dhe dhënia e shërbimeve mjekësore dhe shëndetësore të lidhura me to. Zotërimi, menaxhimi, përdorimi, ushtrimi i aktivitetit të agjencive publicitare, të agjencive të komunikimit, medias së shkruar apo radiotelevizive, portaleve online si dhe dhënia e shërbimeve të lidhura me to; Aplikimi, konkurrimi, përfitimi për grante, donacione, dhurata, financime, sponsorizime, nga burime buxhetore, private, me karakter kombëtar apo ndërkombëtar. Aktivitete financiare. Zotërimi i kuotave, aksioneve, të drejtave, si dhe themelimi apo pjesëmarrja në aktivitete të ndryshme tregtare, persona juridik, OJF. Dhënia e shërbimeve të mësipërme për llogari të palëve të treta, përfshirë këtu shërbime të organizimit administrativ, administrim i aktivitetit sportiv dhe tregtar, marrja përsipër dhe menaxhimi i të drejtave kontraktore të çfarëdo natyre për llogari të të tretëve, konsulentë dhe shërbime administrimi, financiare, strategjike, teknike sportive; Çdo lloj aktiviteti tjetër i nevojshme për realizimin dhe përmbushjen e objektivave të mësipërme. Shoqëria mund të ushtrojë të gjitha aktivitetet e mësipërme në paragrafin 5.1 për llogari të saj ose për llogari të të tretëve në bazë të kontratave përkatëse për dhënie shërbimi me këto palë. Shoqëria mund të hapë gjithashtu zyra dhe degë në çdo vend tjetër në botë ku do ta ketë të mundur, apo të ndërmarrë të gjitha transaksionet tregtare, industriale, financiare, pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme të nevojshme, ose që konsiderohen të dobishme për arritjen e qëllimit të saj: mund të kontraktojë kredi dhe financim në përgjithësi, mund të zotërojë interesa, kuota/aksione, dhe çfarëdo pjesëmarrje në kapitalin e shoqërive të tjera, përfshirë shoqëritë, të cilat kanë objekt tjetër direkt apo indirekt. Përveç kësaj në përfundim të*



me legjislacionin shqiptar, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet që lidhet direkt ose indirekt, qështë rezultat ose lidhet me objektivin e mësipërm.)

Në Pasqyrat Financiare të shoqërisë të vitit 2022 rezultojnë këto të dhëna si dhe posti i azhurnuar pas kontabilizimit të Vendimit të destinimit të Humbjeve të vitit 2023 nga aksioneri i vetëm:

		31.12.2022	Postet e kapitalit me 30.11.2023 (para zmadhimit të kapitalit)
1. Aktivët Afatshkurtëra	leke	8,671,543	-
2. Aktivët Afatgjatë	leke	3,753,536	-
3. Detyrimet Afatshkurtera	leke	89,125,156	-
4. Detyrimet Afatgjatë	leke	0	-
4. Kapitali	leke	-76,700,077	-
Nga ky:			
● Kapitali i nënshkruar	leke	3,500,000	3,500,000
● Primi i lidhur me Kapitalit	leke	0	0
● Rezerva Rivleresimi	leke	0	0
● Rezerva Ligjore	leke	0	0
● Rezerva te tjera	leke	0	0
● Fitimi i pashperndare	leke	-18,260,641	-80,200,077
● Fitimi i vitit	leke	-61,939,436	0

Mbi bazën e të dhënave të mësipërme del se aktivet e shoqërisë me 31.12.2022 janë gjithsej 12,425,079 lekë ndërsa detyrimet ndaj të tretëve dhe palëve të lidhura janë 89,125,156 lekë (nga ku pjesën më të madhe e zenë kontributet e ortakut për rritjen e kapitalit të nënshkruar), pra kapitalet e veta të shoqërisë mbeten -76,700,077 lekë dhe përbëjnë garanci të plotë për Aksionerin e vetëm të shoqërisë "FUTBOLL CLUB DINAMO CITY" ShA që të rrisë kapitalin e nënshkruar të kësaj shoqërie për shumën prej totale prej 70,000,000 lekësh (sipas kërkesës së vetë subjektit).

Referuar Pikës 2.i. të Vendimit nr. 4 të datës 23.11.2023 "PER EMERIMIN E AUDITUESIT LIGJOR (EKSPERTIT KONTABEL TE REGJISTRUAR) PER TE BERE VLERESIMIN KONABEL TE KAPITALEVE TE SHOQERISE" të Aksionerit të vetëm Rritja në Kapital do të ndodhë nga një burim dhe më konkretisht si më poshtë paraqitur:

- 70,000,000 lekë lekë do të kryejnë rritjen në Kapital nga fonde të vetë aksionerit të vetëm për të cilat do të paraqiten dhe verifikimet e kryera më poshtë në materialin e përgatitur nga ana jonë; Kapitali i nënshkruar kalon në vlerën totale prej 73,500,000 lekë pas kontabilizimit edhe të kësaj vlere rritje në kapitalin e nënshkruar.

#### Bazat për Konkluzione:

- Për mendimin tonë, bazuar në procedurat e kryera, procesi i Zmadhimit të kapitalit vjen nga një burim nga ku edhe janë fokusuar verifikimet tona:
  - Shumat e depozituara nga aksioneri i vetëm i shoqërisë në vlerën totale të 62,000,000 Lekë (kapital i paguar) si dhe vlera prej 8,000,000 lekë (kapital që do të paguhet) që do të depozitohet në llogaritë e shoqërisë nga aksioneri i vetëm. Z. Adrian BARDHI ka kryer midis të tjerash depozitim në llogaritë e shoqërisë të vlerave në nivelin e 62,000,000 Lekë dhe pjesën e mbetur pritet që ta paguajë në vijim. Ai po në vendimin Nr. 4 të dt. 23.11.2023 ka shprehur vullnetin e tij që me këto fonde të kryhet rritja e Kapitalit të nënshkruar edhe për 70,000,000 Lekë. Zmadhimi i kapitalit është për pjesën takuese me vlerë 70,000,000 lekë, te ardhura këto nga

jashtë shoqërisë "FUTBOLL CLUB DINAMO CITY" Sh.A. që pasi u kryen verifikimet e nevojshme e kanë burimin nga të ardhura të tatuara të shpjeguara si më poshtë vijojnë :

Lloji i të ardhures	Totali i të ardhurave të verifikuara sipas viteve
Dividend i shpërndarë për Z. Adrian BARDHI në vitin 2019	70,000,000
TOTAL	70,000,000

- Është për tu theksuar në këtë pjesë se në analizën e verifikimit të të ardhurave të z. Adrian BARDHI nuk janë përfshirë të gjitha të ardhurat personale të tij pasi jemi mjaftuar me përmbushjen e vlerës prej 70,000,000 lekë për të dhënë siguri të arsyeshme mbi vlerën e kërkuar nga ai si aksioner i vetëm për rritjen e kapitalit të nënshkruar të shoqërisë "FUTBOLL CLUB DINAMO CITY" Sh.a.
- Burimi i të ardhurave është konstatuar dhe verifikuar:
  - si në deklaratimet individuale të kryera nga individ Z. Adrian BARDHI me Nr. ID M12121037S dhe nr. Letërnjoftimi 027643596,
  - në deklaratat e tatimit të mbajtur në burim nga subjekti AD Pascucci Sh.p.k. për llogari të individit Z. Adrian BARDHI me Nr. ID M12121037S dhe nr. Letërnjoftimi 027643596,
  - ashtu edhe në vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës me Nr. 7509/1 Prot. Dt. 21/12/2023 me qëllim vërtetimin sipas kërkesave ligjore për burimin e të ardhurave, të cilët na janë vënë në dispozicion nga pala e interesuar.

	<u>30.11.2023</u>	<u>31.12.2022</u>
Kapitali aksionar	73,500,000	3,500,000

Pasqyra Financiare e Kapitalit Aksionar, për qëllim të zmadhimit të kapitalit themeltar të shoqërisë, si dhe shënimet e lidhura me to, japin një paqym të sigurtë dhe të vërtetë të gjendjes së depozitimeve nga aksioneri që i kanë depozituar në llogaritë bankare të shoqërisë për ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2022 dhe në vijimësi përgjatë vitit 2023.

2. Llogaritjet e kryera për të përcaktuar shtesën e kapitalit nëpërmjet 3,500 aksione me rritje në vlerën nominale të një aksioni në 21,000 lekë/aksion, pasqyrojnë me vërtetësi raportin e depozitave bankare në kapital të shoqërisë. Miratohet forma juridike e zmadhimit të kapitalit duke ndryshuar vlerën nominale të një aksioni si dhe respektimin e kuotave të shpërndara, kuota të cilat mbeten të pandryshuara:
  - Z. Adrian BARDHI - shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, i cili zotëron 100% (njëqind përqind) të aksioneve pas zmadhimit të kapitalit vlera i shkon 73,500,000 lekë me nr. aksionesh prej 3,500 copë me një vlerë prej 21,000 lekë/aksion.

	<u>30.11.2023</u>	<u>30.11.2023</u>
Te drejta e detyrime ndaj ortakeve	70,000,000	

Veprimet kontabile që do të kryhen janë :

**Debi** : Llogaria "Të drejta ndaj pronarëve për kapitalin e nënshkruar"

70,000,000 leke

**Kredi** : Llogaria "Kapitali i nënshkruar i paguar"

62,000,000 leke

**Kredi** : Llogaria "Kapitali i nënshkruar i pa-paguar"

8,000,000 leke

**PASQYRA LLOGARITJEVE TË AKSIONEVE TË KAPITALIT PËR EFEKTE TË ZMADHIMIT TË KAPITALIT AKSIONAR.**

Aksionerët e shoqërisë	Pjesë-marrja %	Nr. Aksioneve	Vl. nom. e aksionit	Kapitali aktual	Zmadhimi i kapitalit në vlerë	Rritja e vlerës nom. Për aksion	Vl. Nom e aksionit pas rritjes	Totali I Kapitalit pas zmadhimit në vlerë	Totali I aksioneve pas zmadhimit
Adrian BARDHI	100%	3,500	1,000	3,500,000	70,000,000	20,000	21,000	73,500,000	3,500
<b>Totali</b>		<b>3,500</b>		<b>3,500,000</b>	<b>70,000,000</b>	<b>20,000</b>		<b>73,500,000</b>	<b>3,500</b>

**Si konkluzion përfundimtar :**

Kapitali Themeltar i shoqërisë " FUTBOLL CLUB DINAMO CITY " Sh.A. rritet për 70,000,000 lekë me 70,000,000 Lekë me kontribut monetar nga jashtë shoqërisë (fonde të aksionerit të vetëm), ose nga 3,500,000 lekë bëhet **73,500,000 lekë** i ndarë në **3,500 aksione** me vlerë nominale prej 21,000 lekë seicila me kontribut si me poshte:

- 100 % i zotëruar nga aksineri i vetëm Z. Adrian BARDHI

**AUDITUES LIGJOR  
(EKSPERT KONTABEL I RREGJISTRUAR)**

Arber GJATA